

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GLOBAL IMPORT EXPORT” SHPK

Sot, më datë 13/09 /2018, ortakët si më poshtë:

1. **Z. Armando Grazioli**, shtetas italian, lindur më 15.11.1987 në San Giorgio a Cremano (NA), Itali dhe banues në San Giorgio a Cremano, në adresën: Via “Botteghelle”, n. 212, s.A i.1, identifikuar me Kartën e Identitetit me Nr. AY 4840760;
2. **Z. Giuseppe Trombetta**, shtetas italian, lindur më 17.03.1975 në Napoli, Itali, dhe banues në San Giorgio a Cremano (NA), në adresën: Via “Botteghelle”, No. 212, s.A i. 2, identifikuar me Kartën e Identitetit me Nr. AU 4343972;

Vendosën të hartojnë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

NENI 1
DATA E THEMELIT

Sot, më datë 13/09 /2018, themeluesit Armando Grazioli dhe Giuseppe Trombetta vendosën të krijojnë një shoqëri me emërtimin “Global Import Export” SHPK.

NENI 2
FORMA E SHOQËRISË


Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

NENI 3
EMËRTIMI

Emri i plotë i shoqërisë është “Global Import Export” shpk.

NENI 4
SELIA

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Tiranë, Njesia Administrative Nr. 7, Rruga “Muhamet Gjollesha”, Godina midis Tirana Ring Center dhe Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”, Kati 5, Ap. 46. Me miratim të organeve të saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.



NENI 5
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria “Global Import Export” shpk do të ketë si objekt të veprimtarisë:

Import Eksport u automobilave, motorave dhe motoçikletave, aksesoreve dhe lubrifikantëve. Çdo aktivitet tjetër tregtar që lidhet në mënyre të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 7
KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortakët si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e Pjesmarrjes
Armando Grazioli	50 %	1	5.000 (Lek)
Giuseppe Trombetta	50 %	1	5.000 (Lek)

Ky kapital është i ndarë në 2 (dy) kuota të zotëruara nga dy ortakët.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

NENI 8
ADMINISTRATORI

Administratori i parë i shoqërisë “Global Import Export” shpk do të jetë:

Administrator i parë i shoqërisë do të jetë **znj. Dhimitrulla Vasili**, shtetase shqiptare, lindur më 01.08.1992 në Polenë, Korçë dhe banuese në Tiranë, në adresën: Rruga “Llukë Kacaj, pallati “2-END”, Nr. 10, Kati 2, Hyrja 1, Tiranë, identifikuar me Kartën e Identitetit me Nr. 033460784.

Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9
DISPOZITAT E FUNDIT



Ky akt themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.
Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar, gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.
Autorizohet Administratori znj. Dhimitrulla Vasili për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

THEMELUESIT

ARMANDO GRAZIOLI

ARMANDO GRAZIOLI



GIUSEPPE TROMBETTA

TROMBETTA Giuseppe

